



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Didaktikë e Gjuhëve të Huaja (2)

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 30 leksione / 10 seminare

Viti / Semestri : Viti III , semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor – *Gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian*

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Lënda synon të ofrojë njohuri bazë lidhur me didaktikën e gjuhëve të huaja të nevojshme këto për një studim më të thelluar në studimet e nivelit të dytë Master Mësuesi. Synimi i kësaj lënde është që njohuritë që ofrohen të mundësojnë jo vetëm një formim bazë të tij për studime të mëtejshme por që ti shërbejnë atij edhe për një formim të përgjithshëm lidhur me nocionet bazë të didaktikës së gjuhëve të huaja.

Objektivat specifike lëndore:

Lënda ka si objektiva specifike të informojë dhe të formojë studentin në lidhje me :

- 1.Koncepte themelore të didaktikës së gjuhës së huaj
- 2.Dallimin ndërmjet koncepteve gjuhë huaj, gjuhë e dytë, gjuhë etnike, gjuhë klasike
- 3.Objektivat glodidaktike dhe glotomatetike.

Rezultate të pritshme:

- 1.Aftësitë gjuhësore bazë dhe ato të integruara
- 2.Teknikat dhe veprimtaritë bazë në zhvillimin e aftësive gjuhësore
- 3.Llojet e njësive didaktike dhe strukturimi i tyre
- 4.Njohja dhe përdorimi i materialit autentik për ndërtimin e njësive didaktike në lidhje me nivelin, moshën dhe nevojat e nxënësit.
- 5.Njohja e llojeve të testimeve dhe forma e vlerësimit të tyre.
 - Problematikat në realizimin e testeve
 - Problematikat në vlerësimin.